



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 26

Tiranë – E hënë, 15 shtator 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 11466/2, datë 9.9.2025	3
Njoftim i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 11467/2, datë 9.9.2025	4
Urdhër i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 447, datë 11.9.2025	5
Njoftim i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 11241/5, datë 15.9.2025	8
Kërkesë e Agjencisë së Trajtimit të Pronave nr. 4746, datë 10.9.2025	9



NJOFTIM
Nr. 11466/2, datë 9.9.2025

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË
AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË
PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE
TË KONFISKUARA**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret

e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III, shpallen për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi	Viti i prodhimit	Vlera fillestare e ankandit në lekë	Zhvillimi i ankandit		
				Data	Ora	Vendi
1	Volkswagen Bora	2001	30 000	2.10.2025	10:00	DSHPP
2	BMW	2002	30 000	2.10.2025	10:30	DSHPP
3	Audi	1991	22 500	2.10.2025	11:00	DSHPP
4	Motor varke model Mercury	-	12 000	2.10.2025	11:30	DSHPP
5	Mercedes Benz	1999	20 000	2.10.2025	12:00	DSHPP
6	Audi	2004	32 000	2.10.2025	12:30	DSHPP
7	Audi	2002	35 000	2.10.2025	13:00	DSHPP
8	Motor uji Jet-Ski	-	8 000	2.10.2025	13:30	DSHPP
9	Motor Kawasaki	-	5 000	2.10.2025	14:00	DSHPP
10	Volkswagen Phaeton	2003	40 000	2.10.2025	14:30	DSHPP
11	Mercedes Benz ML skelet	2009	18 000	2.10.2025	15:00	DSHPP
12	Furgon Volkswagen	2002	30 000	2.10.2025	15:30	DSHPP
13	Biçikletë	-	500	2.10.2025	16:00	DSHPP
14	Renault Megane	2004	25 000	2.10.2025	16:30	DSHPP
15	Smart	2003	25 000	2.10.2025	17:00	DSHPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin, si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerje e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

2. **Garancinë bankare apo mandatpagesën** në origjinal, që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. **Deklarim personal të secilit pjesëmarrës**, që vërteton se ky i fundit nuk është në konflikt interesi, sipas dispozitave të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 34/2019, të ndryshuar.

4. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare apo mandatpagesa duhet të bëhet detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandatpagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pasi të kenë tërhequr pranë kësaj agjencie faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.



NJOFTIM
Nr. 11467/2, datë 9.9.2025

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË
INSTITUTIT TË PËRGATITJES SË
QENVE TË POLICISË**

e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III shpallen për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret

1. Në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë

Nr.	Emërtimi	Datëlindja	Vlera fillestare e ankandit në lekë	Zhvillimi i ankandit		
				Data	Ora	Vendi
1	Qeni Delta	19.11.2016	5,000	1.10.2025	10:00	DSHPP
2	Qeni Laika	13.4.2018	5,000	1.10.2025	10:30	DSHPP
3	Qeni Brend	17.7.2019	5,000	1.10.2025	11:00	DSHPP
4	Qeni Diezel	6.1.2016	5,000	1.10.2025	11:30	DSHPP
5	Qeni Hejko	14.10.2020	5,000	1.10.2025	12:00	DSHPP
6	Qeni Dorfi	19.1.2016	5,000	1.10.2025	12:30	DSHPP
7	Qeni Lena	4.4.2023	5,000	1.10.2025	13:00	DSHPP
8	Qeni Kiri	24.12.2017	5,000	1.10.2025	13:30	DSHPP

Nr.	Emërtimi	Datëlindja	Vlera fillestare e ankandit në lekë	Zhvillimi i ankandit		
				Data	Ora	Vendi
1	Qeni Brandi	12.4.2014	5,000	1.10.2025	14:00	DSHPP
2	Qeni Sindi	15.11.2015	5,000	1.10.2025	14:30	DSHPP
3	Qeni Liza	1.11.2014	5,000	1.10.2025	15:00	DSHPP
4	Qeni Vreni	28.9.2018	5,000	1.10.2025	15:30	DSHPP
5	Qeni Mega	12.11.2014	5,000	1.10.2025	16:00	DSHPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin, si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerje e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

2. Garancinë bankare apo mandatpagesën në origjinal, që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

3. Deklarim personal të secilit pjesëmarrës, që vërteton se ky i fundit nuk është në konflikt interesi, sipas dispozitave të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 34/2019, të ndryshuar.

4. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e

shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare apo mandatpagesa duhet të bëhet detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandatpagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, pasi të keni tërhequr pranë DSHPP-së, ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.



URDHËR

Nr. 447, datë 11.9.2025

**PËR NJOFTIMIN E FILLIMIT TË
PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES SË
ANËTARIT TË BORDIT TË
ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES I
MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR
ARSIMIN, NË UNIVERSITETIN E
ARTEVE, TIRANË, MËNYRËN E
VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE
AFATIN E DORËZIMIT TË
DOKUMENTACIONIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës; të nenit 48, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; dhe të pikës 7, të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”,

URDHËROJ:

1. Njoftimin e fillimit të procedurës së përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin e Arteve, Tiranë, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtar të Bordit të Administrimit të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave dhe shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët, për anëtar të Bordit të Administrimit, do të jetë deri më datë 29.9.2025.

4. Publikimi i kriterëve dhe i procedurave që do të ndiqen për konkurrimin, për pozicionin e anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin në Universitetin e Arteve, Tiranë, të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së

Prokurimit Publik.

5. Lista e kandidatëve të përzgjedhur publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin: www.arsimi.gov.al.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Ogerta Manastirliu

SHTOJCA NR. 1

**NJOFTIM
PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARIT TË
BORDIT TË ADMINISTRIMIT,
PËRFAQËSUES I MINISTRISË
PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE, TIRANË**

Në zbatim të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”; dhe urdhrit nr. 447, datë 11.9.2025, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin e Arteve, Tiranë, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall njoftimin për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i MAS-it, në institucionin publik të arsimit të lartë, si më poshtë:

Nr.	Institucioni publik i arsimit të lartë	Numri i anëtarëve për Bord Administrimi
1	Universiteti i Arteve Tiranë	- 1 anëtar përfaqësues i MAS-it

1. Përshkrim i përgjithshëm

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.



Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listave të propozuara nga institucioni i arsimit të lartë. Në listën e kandidatëve jepen të dhënat e individëve që vetëkandidojnë, apo propozohen nga njësitë bazë të institucionit të arsimit të lartë, apo institucioneve përkatëse. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.

2. Kompetencat dhe funksionet e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
- vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;
- jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
- përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
- është përgjegjës për caktimin e kritereve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;

- emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;

- miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;
- miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.

3. Kërkesat e pranimit

a) Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike;
- Të ketë integritet etik dhe profesional;
- Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;
- Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati:

- Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë;
- Të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar;
- Të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit, para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- Të mos ketë ndaj tij masë disiplinore në fuqi;
- Të njohë të paktën një gjuhë të huaj;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

4. Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit:

- Kërkesë për aplikim;
- Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV – Curriculum Vitae);



- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën “Bachelor”). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet vërtetimi i njohjes dhe i njësimit të diplomës/certifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse;

- Fotokopje të librezës së punës;
- Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj;
- Formular i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
- Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1;

- Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2;

- Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3;

- Vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor, ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

5. Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër, do të jetë deri në datën 29.9.2025 në një nga këto mënyra:

a) Me postë zyrtare në adresë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

b) Dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, e cila vë në dispozicion të komisionit *ad hoc* të ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

6. Mënyra dhe koha kur do të shpallet lista e kandidatëve të përzgjedhur

- Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit kryhet nga një komision *ad hoc* i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 10 ditëve pune, nga data e përfundimit të afatit të aplikimit dhe harton listën e kandidatëve të kualifikuar, që plotësojnë kriteret ligjore.

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Arsimit dhe Sportit do të shpallë kandidatin e përzgjedhur në faqen e saj zyrtare: www.arsimi.gov.al.

7. Masa e shpërblimit

Bazuar në VKM-në nr. 656, datë 31.10.2018, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar, kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në Bordin e Administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

SHTOJCA NR. 1/1

Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordin Administrimi në institucionin publik të arsimit të lartë, deklaroj se _____ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.

Datë _____

Nënshkrim _____

SHTOJCA NR. 1/2

Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordin Administrimi në institucionin publik të arsimit të lartë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të



interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrim _____

SHTOJCA NR. 1/3

Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar Bordi në institucionin publik të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë _____

Nënshkrim _____

NJOFTIM

Nr. 11241/5, datë 15.9.2025

**PËR ANULIMIN E PROCEDURËS SË
ANKANDIT**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III, pika 6, germa “a”; dhe të ligjit nr. 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, i cili në kreun III, neni 9, pika 6, parashikon: “Parashikimet aktuale në aktet ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me botimin në median kombëtare, zëvendësohen me botimin në Buletin e Njoftimeve Zyrtare”, kërkojmë nga ana juaj të botoni publikimin për anulimin e ankandit për shitje nr. 11241/2, datë 2.9.2025, botuar në Buletin e Njoftimeve Zyrtare nr. 25, datë 8.9.2025, për arsye të vonësës së përditësimit të dokumenteve të pronësisë. Ankandi anulohet deri në një njoftim të dytë.



KËRKESË
Nr. 4746, datë 10.9.2025

**PËR PUBLIKIMIN E REGJISTRIT TË VENDIMEVE, TË CILAT KANË NJOHUR TË
DREJTËN PËR KOMPENSIM DHE VLERËSIMEVE PËR VITET 1993, 1994, 1996–2001,
2006–2009, 2012**

Agjencia e Trajtimin të Pronave ju njofton, se referuar nenit 19, “Ankimi ndaj vlerësimit financiar”, të ligjit nr. 133/2015: “Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër vlerësimit financiar të kryer nga ATP-ja për përcaktimin e vlerës së pronës në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 30 ditëve nga dita e publikimit, vetëm për vlerën e kompensimit.”

Problematika/Mungesë dokumentacioni	Dok. ligjor për përcaktimin e s. kadastral të origjinës	Sip. e kthyer (kompensuar fuqishëm) përfundimtare						Sip. për kompensim përfundimtare										VLERËSIM FINANCIAR	SHËNIME
		Sipërfaqja m ² totale	Zëri kadastral i origjinës				Zëri kadastrale	Sipërfaqja m ² totale	Zëri kadastral i origjinës				Zëri kadastrale	Zëri kadastral aktual					
			Zëri kadastral - vendl	Zëri kadastral - vendl bujqësor	Zëri kadastral bujqësor - llogarit	Zëri kadastral - pjt			Zëri kadastral - vendl	Zëri kadastral - vendl bujqësor	Zëri kadastral bujqësor - llogarit	Zëri kadastral - pjt		Zëri kadastral - vendl	Zëri kadastral - vendl bujqësor	Zëri kadastral - bujqësor-llogarit	Zëri kadastral - pjt		
Në hartën e vendimit nuk është e ndëru sipërfaqja e kthimit nga ajo e parashikuar dhe ajo e kompensimit. Sipërfaqja 51, 52, 53, 54, 55, që janë kthyer me vendimin nr. 1621, datë 26.12.2002 të Gjykatës ndëshkon jashtë sipërfaqes së njohur me vendimin nr. 44, datë 10.12.1993. Sipërfaqja totale e pozicionuar në hartën e vendimit nr. 44 është me 6 mullatë të drejtë e regjistruar në vendim dhe kontestuar është 38 dyqym dhe jo 30 dyqym që janë trajtuar me vendimin e gjykatës.	Vendim gjykatë në çështje verifikimi të faktit të ngjarjes së procesit, nuk përcaktohet zeri kadastral i origjinës. Vendim nr. 47, datë 07.06.1943 i Komitetit Ekzekutiv të KNG, dhe notes se transkriptimit nr. 77, datë 16.05.1946 është sekuestruar sipërmund Jona Komarov (Keremov, Krenov) 30 dyqym bujqësorë. Vendim nr. 47, datë 07.06.1943 të Komitetit Ekzekutiv të KNG, dhe notes se transkriptimit, sipërmund Jona Komarov (Keremov, Krenov) i sekuestrohet 30 dyqym të punës. Vendimi i gjykatës ka vendosur kthim e një sipërfaqje 2880 m ² e ndëru në 10 parçela si dhe ndëshkon plotën 3 të vendimit për sipërfaqja e kompensimit në masën 23880 m ² . Sipërfaqja e kthyer është pozicionuar në hartën bujqësikëdhëtar kurrë vendimi ndëru sipërfaqja e mbetur për kompensim prej 23880 m ² nuk është pozicionuar.	3440		2880			3981,8532	23880.00 dhe Paraboljeje 1528.00	-	23,880.0	-	-	3981,8532	25,400.0	-	-	-		
Plotesuar me vendimin nr. 6/1 dh. 30.04.1998, me vendimin nr. 6/2 dh. 28.08.1998 i cili gërdet në cilësinë e kopjes e notuar me vendimin nr. 205 dh. 05.05.2004. Mbi vendosje me vendimin 11/2 14.12.1995 me subjektin Ali Man Sheni për 1 Mulla. Në hartë nuk janë pozicionuar parçetë e kompensimit por veten kthimi që neutralon me sip me të vogël, duke pozicionuar kthimet pjesë që mbetet është kompensimi i ndëru në dy parçela 2035 dhe 7011 m ² . Referuar Hartes RGJF 41 zeri kadastral i origjinës është tokë bujqësore. Harta janë pa vlerë komision	Referuar dokumentacionit në doje vendim nr. 462 datë 20.10.1993, vendim nr. 44 datë 24.01.1994 i Gjykatës së Rrethit Lezhë dhe vendim datë 13.07.1993 leshuar nga Keshilli i Rrethit Lezhë është konstatuar se zeri kadastral i origjinës se pronës për sip. 10 dyqym ka qenë tokë bujqësore, ndëru për sip. 4000 m ² nuk mund të përcaktohet zeri kadastral i origjinës së pronës. Me vendimin nr. 23, dh. 13.02.2020 të Gjykatës së Apelit Administrativ është vendosur detyrimi i ATP-së për vlerësimin e sipërfaqes 7011 m ² sipas zërit kadastral të origjinës truall; Referuar dokumentacionit në doje vendim nr. 462 datë 20.10.1993, vendim nr. 44 datë 24.01.1994 i Gjykatës së Rrethit Lezhë dhe vendim datë 13.07.1993 leshuar nga Keshilli i Rrethit Lezhë është konstatuar se zeri kadastral i origjinës se pronës për sip. 10 dyqym ka qenë tokë bujqësore, ndëru për sip. 4000 m ² nuk mund të përcaktohet zeri kadastral i origjinës së pronës.Referuar Hartes RGJF 41 zeri kadastral i origjinës është tokë bujqësore.	4354		4354			8632,1987,8633	9646	7,011.0	2,635.0	-	-	8632,1987	9,646.0	-	-	-	26,227,661	
Vendim nuk ka hartë.	- Verifikim hipotekës, dh. 20.05.1993 nuk përcaktohet të gjithë sip për veten 500 m ² truall, sipas hartës truall							200.00 dhe Paraboljeje 1076.14	1,276.1	-	-	-	8514	1,276.1	-	-	-		
37 m ² i janë kthyer huashipronësit në bazë të nenit 17 dh. nenit 21 paraboljeje	- Verifikim procesit nga Zyra e Hipotekës Elbasan	37	37				8523	438	438.0	-	-	-	8523	438.0	-	-	-	4,090,232	
	Vendim procesit leshuar nga hipoteka Komrë dh.27.07.1993 nr.391/18 dh.06.11.1943							170	170.0	-	-	-	8564	170.0	-	-	-	1,451,290	
	VERTETIM KADASTRAL NGA KESHILLI I RRETHIT DT.22.02.1994							831.00 dhe Paraboljeje 241.00	-	872.0	-	-	1495,8592	872.0	-	-	-	573,111	
Prona krijon mbivendosje me Vendimin Nr.904, Dh.13.06.1995, subjekti Pal Koka dhe Vendimin Nr.91, Dh.08.08.2008, subjekti Vasil Vasa.	Referuar dokumentacionit të procesit, nga hipoteka dh. 12.7.1993, plus 4 dhe 6 figurat 25.4) të vijat janë dhe 1. 3.4) të vijat të kësaj mullit. Me vendimin nr. nuk mund të përcaktohet zeri kadastral nga hartat që depozitohen. Me vendimin nr. 2491, dh. 18.8.1994 është bërë vendimi i faktit juridik për 100 dyqym. Referuar hartes I GJ F të vitit 1941 zeri kadastral i origjinës tokë bujqësore.						10000	-	10,000.0	-	-	1574,8511	10,000.0	-	-	-	16,619,000		

Problematika/Mungesë dokumentacioni	Dok. ligjor për përcaktimin e s. kadastral të origjinës	Sip. e kthyer (kompensuar fizikisht) përfundimtare						Sip. për kompensim përfundimtare										VLËRËSIM FINANCIAR	SHËNIME
		Sipërfaqja m ² totale	Zëri kadastral i origjinës				Zona kadastrale	Sipërfaqja m ² totale	Zëri kadastral i origjinës				Zona kadastrale	Zëri kadastral aktual					
			Zëri kadastral - vendl	Zëri kadastral - tokë bujqësore	Zëri kadastral bujqësor - llogar	Zëri kadastral - pyll			Zëri kadastral - vendl	Zëri kadastral - tokë bujqësore	Zëri kadastral bujqësor - llogar	Zëri kadastral - pyll		Zëri kadastral - vendl	Zëri kadastral - tokë bujqësore	Zëri kadastral bujqësor - llogar	Zëri kadastral - pyll		
	Vertetim pronarie nr. 16833, datë 30.4.1994 nga Aktivi i Rrethit Kongoj - 2000 m ² , Tësull, fshati Gëllq.	1005	1005				1403	995	995.0	-	-	-	1403	995.0	-	-	-	1,870,600	
Vendimi është i padotueshëm me harte është injektuar me ligjin nr. 7699, datë 21.04.1993. Vendim kompensimi, i përcaktuar me vlerë dhe code i pajektuar (nëse 6, pika 7 e ligjit nr. 133/2016).	Vertetimi Arkivor datë 30.06.199							40000	-	-	-	-	2965	-	40,000.0	-	-	1,058,210	
NGA HARTAT QË NDODHËN NË DORJE NUK POZICIONOHET	Vertetimi hipotekor, Note transkriptimi							550000	-	550,000.0	-	-	1992	-	550,000.0	-	-	8,143,130	
Vendim pa harte. Prona e njëzës e përmbytur nga ligji i Fierës.	zoti origjinal are sipas dokumentit ligjor ka bashkë vendimi dhe sipas vete vendimit të shk.KKKP							17000	-	17,000.0	-	-	3425	17,000.0	-	-	-	2,244,000	
Parafat kanë mbivendosje vendimin Nr.344 dt.22/09/2008 Sub-Kristo Kumamka.	sipas vendimit - toka bujqësore.							615000	-	615,000.0	-	-	3032	-	615,000.0	-	-	125,460,000	
	Vendim hipotekor dt. 1.11.1993-parcël 23- njëzë shëpi							468.5	468.5	-	-	-	8518	468.5	-	-	-	9,058,950	

Problematika/Mungesë dokumentacioni	Dok. ligjor për përcaktimin e s. kadastral të origjinës	Sip. e kthyer (kompensuar frikësih) përfundimtare						Sip. për kompensim përfundimtare										VLERËSIM FINANCIAR	SHËNIME
		Sipërfaqe m ² totale	Zëri kadastral i origjinës				Zona kadastrale	Sipërfaqe m ² totale	Zëri kadastral i origjinës				Zona kadastrale	Zëri kadastral aktual					
			Zëri kadastral - vendl	Zëri kadastral - tokë bujqësore	Zëri kadastral bujqësor - llojsh	Zëri kadastral - pyll			Zëri kadastral - vendl	Zëri kadastral - tokë bujqësore	Zëri kadastral bujqësor - llojsh	Zëri kadastral - pyll		Zëri kadastral - vendl	Zëri kadastral - tokë bujqësore	Zëri kadastral - bujqësor-llojsh	Zëri kadastral - pyll		
Vendimi nuk e ka të plotësuar rubrikën e titullit shkencor. Referuar dokumentacionit ligjor dhe hartave nuk mund të përcaktohet zeri kadastral i origjinës së pronës gjithashtu nuk mund të përcaktohet zeri kadastral aktual për sipërfaqet për të cilat është njohur e drejta e kthimit të pronës.	Referuar dokumentacionit ligjor të ndodhur në doqjen bazë në arkivën e ATP-se nuk mund të përcaktohet zeri kadastral i origjinës së pronës pasi ka disa zera kadastrali: tokë bujqësore, rrugë, tokë pa fryt, zallësi, ete një sip. prej 1 174.000 m². Referuar hartës KQJF-41 ka disa zera kadastral të origjinës duke qenë se sipërfaqe shumë mëdhe jemi në pamundësi për ta përcaktuar me saktësi zerin. Prona shpërndahet në dy ZK me emime të ndryshme për për disa zera kadastrali; Për sipërfaqet e lloj: 5379 m², 9458 m², 11 409 m² dhe 10 000 m² zeri kadastral aktual është zallësi dhe tokë e paqylyshme. Referuar VKM nr. 89, datë 05/05/2016 "Për miratimin e hartës së vlerës në Republikën e Shqipërisë", nuk është përcaktuar vlera për pronat e llojsh "tokë e paqylyshme". Në këtë kusht, me miratimin e subjektit zeri kadastral aktual për llojet sipërfaqe, mund të vlerësohet me çmimin minimal të përcaktuar në hartën e vlerës nga të gjitha kategoritë për atë llojsh;	36226					2022,1001	1012870	-	-	-	-	2022,1001	301000,0	982,870,0	-	-		
dokument hipotekor - rrugë								124,8	124,8	-	-	-	8380	124,8	-	-	-	8,357,731	

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.



Tiranë, 2025